

Emri i Lëndës : Menaxhim Risku							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
EMS 301	B	Vjeshtë	3.00	1.00	0.00	3.50	5.00
Lektori		Gentjan Gegaj, Msc					
Asistenti		Blisard Zani, Msc					
Gjuha e kursit		Anglisht					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Ky kurs përmban leksione për trajtimin e njohurive gjithëpërfshirëse në fushën e menaxhimit të riskut. Duke trajtuar secilin koncept të programit në rend kronologjik, studentët do të jenë në gjendje të përkufizojnë konceptin kryesor të riskut, si dhe njohjen e gjithë proceseve të plota për trajtimin e tij sipas teknikave të ndryshme. Njëkohësisht, studentët do të prezantohen edhe me konceptet probabilitare për vlerësimin sasior të riskut, si dhe ndërtimin e portofoleve me tituj me risk, të korreluar në vlera të ndryshme.					
Objektivat		Në përfundim të kursit, studentët do të jenë në gjendje të: • Përkufizojnë saktë konceptin e riskut, • Dallojnë riskun nga pasiguria, • Njohin gjithë hapat për procesin e menaxhimit të riskut, • Zgjedhin teknikën e duhur për menaxhimin e riskut, • Ndërtojnë saktë frontin eficient me kombinimet e titujve, • Njohin shpërndarjet probabilitare për vlerësimin e riskut, • Ndërtojnë pemët e vendimit bazuar mbi vlerat e probabiliteteve, etj.					
Konceptet Kryesore		Risku, Pasiguria, Shanci, Probabilitet, Vlerësim Risku, Komunikimi i Riskut, Fronti Eficent, Korrelacioni i titujve, etj.					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Prezantim i kursit dhe programit të lëndës. Prezantimi i librit dhe metodës së vlerësimit.						
2	Konceptet bazë të riskut dhe pasigurisë. Kreu I (fq. 1 – 26) dhe II (fq. 27 – 46) të librit të parë. Këta kapituj japin një prezantim të përmbledhur të konceptit bazë të riskut dhe pasigurisë. Kreu i parë na jep një paraqitje të parimeve të studimit të riskut, menaxhimi i tij, si dhe arsyet se përse është e nevojshme të realizohet studimi i riskut. Në kreun e dytë studiohet koncepti i pasigurisë, llojet e saj, si dhe burimet sasiore dhe cilësore të pasigurisë.						
3	Menaxhimi i riskut. Kreu III (fq. 47 – 97) i librit të parë. Ky kapitull trajton më thellësisht procesin e menaxhimit të riskut, duke u ndaluar në secilin hap për menaxhimin e riskut. Gjatë këtij kreu studiohet identifikimi i riskut, vlerësimi sasior paraprak, vlerësimi i rikut, kontrolli i objektivave dhe në fund procesi i modelimit të riskut.						
4	Llogaritja dhe vlerësimi i riskut. Kreu IV (fq. 99 – 131). Në këtë kre prezantohen shtrohen për diskutim pyetjet se si duhet të realizojmë procesin e llogaritjes së riskut, si dhe aktivitetet konkrete që nevojiten për këtë vlerësim. Në vijim prezantohen karakteristikat e riskut, dokumentimi i tij, si dhe metodat sasiore dhe cilësore për vlerësimin e riskut në këndvështrimin e projekteve të ndryshme.						
5	Komunikimi i riskut. Kreu V (fq. 133 – 169). Kreu i pestë analizon një prej tre shtyllave kryesore të menaxhimit të riskut: komunikimin e tij. Qasja e këtij kapitulli lidhet me trajtimin e metodave se si duhet komunikuar fenomeni i riskut brenda një organizate. Më pas, komunikimi i riskut shihet në këndvështrimin e komunikimit brenda organizatës, dhe jashtë saj. Së fundmi, ky kre paraqet diktutimin mbi përfshirjen publike në komunikimin e riskut, si dhe eksternalitetet që vijnë prej burimeve të riskut.						

6	Menaxhimi i riskut të ndërmarrjeve. Kreu VI (fq. 173 – 205). Ky kapitull ndalet më konkretisht në menaxhimin e riskut në ndërmarrjet, si organizatat kryesore ekonomike. Kreu na prezanton me arsyet e studimit të riskut në ndërmarrje, si dhe me trendet më të fundit në menaxhimin e riskut në organizata të ndryshme. Paralelisht, kapitulli na jep një pamje të plotë të standardeve (ISO) dhe praktikave të menaxhimit të riskut vitet e fundit.
7	Përsëritje përpara provimit gjysmë – final. Quiz për konceptet e krerëve I – VI.
8	Provimi gjysmë final.
9	Identifikimi i problemit dhe menaxhimi i riskut. Kreu VII (fq. 207 – 233). Kreu i shtatë na paraqet të përmbledhur procesin se si duhet identifikuar saktë problemi dhe burimi i riskut. Si hapi i parë, identifikimi i riskut ka rëndësi pasi është pikënisja e vlerësimit të mëvonshëm sasior të riskut. Kreu paraqet më pas edhe kornizat se si duhet identifikuar problemi, si dhe parashtrimin e teknikave më të rëndësishme që duhen përdorur për menaxhimin e tij.
10	Ekonomiksi i menaxhimit të riskut. Kreu IX (fq. 251 – 271). Në kreun e nëntë të librit trajtohet koncepti i ekonomiksit brenda kontekstit të menaxhimit të riskut. Studentët do të njihen me diskutimet që kanë të bëjnë me konceptet e kostove oportune, vendimmarja në kushtet e riskut, marrëdhënia korrelative mes burimeve të riskut, etj. Njëkohësisht, kreu IX prezanton edhe eksternalitetet negative në formën e dështimeve të tregut, apo dështimin e politikave publike për të menaxhuar si duhet risqet.
11	Teoria e portofolit me variancë mesatare. Kreu IV (fq. 41 – 64) – libri i dytë. Në këtë kapitull trajtohet metoda statistikore e mundësive ekonomike në kushtet e riskut. Kapitulli ndalet gjerësisht në përcaktimin e vlerës së pritshme mesatare të kthimit, si dhe vlerësimin e riskut bazuar në variancën dhe devijimin standard të kthimeve. Në vijim prezantohen vlerësimet e riskut mbi treguesin e devijimit standard dhe korrelacionit të kthimeve.
12	Përvijimi i frontit eficient. Kreu V (fq. 65 – 106) – libri i dytë. Ky kapitull prezanton konceptin e froncit eficient, si dhe hapat për ndërtimin e tij. Në secilin prej kombinimeve dhe korrelacionit mes titujve si aksione dhe obligacione jepet forma grafike e frontit potencial eficient. Njëkohësisht studiohet edhe forma e frontit në kushtet e lejimit të shitjes shkurt të titujve.
13	Vështrim mbi probabilitetin. Kreu XII (fq. 449 – 464) – libri i parë. Kreu mbi probabilitetin na prezanton me konceptet bazike të shancit, mundësisë, dhe vlerave probabilitare për ngjarjet e ndryshme me risk. Si një nga shtyllat qendrore të teorisë së riskut, vlerësimi probabilitar është kyç sidomos në vendimmarrjet që realizojnë individët, organizatat dhe ndërmarrjet. Ky kapitull trajton rregullat kryesore të probabilitetit, probabilitetin e ngjarjeve me kusht si dhe teoremën Bayesiane të ngjarjeve probabilitare.
14	Përzgjedhja e shpërndarjes probabilitare. Kreu XIII (465 – 510). Kapitulli trajton llojet e ndryshme të shpërndarjeve probabilitare, në varësi të llojeve të ndryshme të ngjarjeve me risk. Në vijim të kreut prezantohen edhe disa shembuj konkretë se si duhet të përdoren secila prej shpërndarjeve të ndryshme, si dhe prezantimi grafik i secilës prej tyre.
15	Përsëritje përpara provimit final. Quiz për konceptet e krerëve pas provimit gjysmë final.
16	Provim Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.		
Literatura	• Charles Yoe: “Principles of Risk Analysis - Decision Making Under Uncertainty” (second edition) 2019 CRC Press – ISBN: 13: 978-1-138-47820-6 • E. Elton; M. Gruber; S. Brown; W. Goetzman: “Modern Portfolio Theory and Investment Analysis” (ninth edition) 2014 WILEY – ISBN 978-1-118-46994-1		
Referenca të tjera	• Carl Pritchard: Risk Management" – Concepts and guidance” (fifth edition) 2015 CRC Press – ISBN: 13: 978-1-4822-5845-5 • M. Crouhy; D. Galai; R. Mark: “THE ESSENTIALS OF RISK MANAGEMENT” (second edition) 2014 Mc Graw Hill – ISBN: 978-0-07-182115-5 • Steve Allen: “Financial Risk Management – A practitioner’s guide to managing market and credit risk” (second edition) WILEY – ISBN 978-1-118-17545-3		
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat			
1	Të njohë dhe identifikojë konceptin e riskut dhe pasigurisë		
2	Të kuptojnë proceset dhe hapat e menaxhimit të riskut		
3	Të jetë i aftë të realizojë procese të thjeshta të vlerësimit të riskut		
4	Të kuptojë shpërndarjet probabilitare të ngjarjeve me risk		
5	Të jetë i aftë të njohë kuptimin e riskut në këndvështrimin e titujve financiarë		
6	Të njohë konceptet e ekonomiksit të menaxhimit të riskut		
Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme		Sasia	Përqindja
Gjysmë finale		1	30
Kuize		2	20
Projekte		0	0
Projekte semestrale		0	0
Punë laborator		0	0
Pjesëmarrja në mësim		1	10
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			60
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			40
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	13	13
Të tjera	2	5	10
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.00
ECTS			5.00